



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KRYETARI

Nr. 515 prot.

Kamëz, më 24 . 5 .2024

V E N D I M

Nr. 515 , datë 24 . 5 2024

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E RE PËR
ZHVILLIM NË FSHATIN LAKNAS, NË NJËSINË STRUKTURE
KZ_UB_AS3-1_1, BASHKIA KAMËZ.**

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b" dhe nenin 23, pika 14 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Vendimi Nr.294, datë 15.05.2024 të Këshillit të Ministrave "Për Shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim në Fshatin Laknas" Bashkia Kamëz, dhe caktimin e Fondit Shiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese", nenin 13, pika 1, shkronja "b" të Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për percaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", nenin 72 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" (i ndryshuar), Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz, miratuar me Vendimin Nr.1, datë 27.07.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit, Vendimin Nr. 486, datë 17.05.2023 "Për miratimin e ndërmarrjes së nismës për Hartimin e Planit të Detyruar Vendor për Ndërtimin e Shkollës "Sulejman Elezi" në zonën Laknas, në Njësinë Strukturore KZ_UB_AS3-1_1, Bashkia Kamëz, Vendimi i Komisionit Shtetëror i Rindërtimit Nr.17, datë 11.05.2020.

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, në fshatin Laknas, Bashkia Kamëz në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim;
 - b) Materiali hartografik:
- Harta e Përdorimit të Tokës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KRYETARI

- Harta e Parcelave të Zhvilluara dhe të mundshme për zhvillim,
 - Harta e Rrjetit të Kanalizimeve/Ujësjetës/Elektrik/Telefonisë,
 - Harta e Projektimit Urban;
 - Harta e Infrastrukturës së Transportit.
2. Miratohet ndërtimi në Zonë e Re për Zhvillim, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, me qëllim ndërtimin e Gjimnazit "Sulejman Elezi" referuar aktekspertizës së thelluar nga Instituti i Ndërtimit ku është shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, në fshatin Laknas, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbdhjetë) diteve nga data e miratimit të tij.
 4. Plani i Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, në fshatin Laknas të integrohet me Planin e Përgjithshëm Vendor në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar.
 5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

